

UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

Lexoni faqet 1 dhe 2 të këtij materiali, përpara se të plotësoni aplikimin në faqen 3. Ju kualifikoheni për leje parkimi apo targa të veçanta nëse jeni banorë të shtetit të Nju-Jorkut dhe që keni një ose disa aftësi të kufizuara të rënda, të cilat dëmtojnë lëvizshmërinë tuaj. Për përshkrimin e këtyre aftësive të kufizuara shihni Pjesën 2 të aplikimit, në faqen 3 të këtij materiali. Një leje parkimi mund të lëshohet për aftësitë e kufizuara të përhershme ose të përkohshme. Lejet lëshohen në emër të personit me aftësi të kufizuar. Ju nuk keni përse të jeni drejtuesi ose pronari i regjistruar i një automjeti, për të marrë një leje parkimi. Fëmijët e çdo moshe, që kanë një aftësi të kufizuar, janë të kualifikuar për leje, duke përfshirë edhe personat me aftësi shumë të reduktuara shikimi.

1) Për të aplikuar për lejen e parkimit:

- (a) Plotësoni Pjesën 1 të aplikimit në faqen 3. Nëse keni një **AFTËSI TE KUFIZUAR TE PËRHERSHME**, kërkojini mjekut, mjekut osteopat, ndihmës mjekut, infermierit të specializuar, mjekut podiatër (në rastet e aftësive të kufizuara të lidhura me këmbët) ose mjekut optometrist (në rastet e verbërisë) që ta plotësojnë seksionin e Vërtetimit Mjekësor për “aftësinë e kufizuar të përhershme” në Pjesën 2 të formularit të aplikimit dhe më pas t’ju kthejnë atë. Nëse keni një **AFTËSI TË KUFIZUAR TË PËRKOSSHME** që kërkon përdorimin e një pajisjeje ndihmëse, kërkojini mjekut ose mjekut osteopat që ta plotësojë seksionin e Vërtetimit Mjekësor për “aftësinë e kufizuar të përkohshme” në Pjesën 2 të formularit të aplikimit dhe më pas t’ju kthejnë formularin. SHËNIM: Nëse keni një aftësi të kufizuar të përhershme, kërkesa për vërtetimin mjekësor mund të hiqet nga agjenti lëshues, nëse keni një aftësi të kufizuar të dukshme dhe të dallueshme (si p.sh. nuk e keni një këmbë) **OSE** nëse ju **tashmë** i dispononi targat për personat me aftësi të kufizuara të rënda.
- (b) **Ju duhet ta dorëzoni aplikimin e plotësuar pranë agjentit lëshues të caktuar për qytetin, qytezën ose fshatin ku jetoni. MOS E DËRGONI APLIKIMIN TUAJ TE DEPARTAMENTI I MJETEVE MOTORIKE (DMV) - DMV NUK LËSHON LEJE PARKIMI.** Nëse keni leje drejtimi ose një kartë identifikimi për personat që nuk kanë leje drejtimi, e cila jepet nga DMV në shtetin e Nju-Jorkut, duhet ta paraqisni atë pranë agjentit lëshues. Agjenti lëshues do të shkruajë në lejen tuaj tre shifrat e fundit të numrit 9-shifror, që ndodhet në lejen e drejtimit apo kartën e identifikimit për personat që nuk kanë leje drejtimi, për t’i ardhur në ndihmë autoriteteve ligjzbatuese që të identifikojnë mbajtësin real të lejes, si dhe për të reduktuar shkeljet. **NUK JU KËRROHET QË TË KENI NJË LEJE DREJTIMI OSE KARTË IDENTIFIKIMI PËR PERSONAT QË NUK KANË LEJE DREJTIMI, TË LËSHUAR NGA DMV E SHTETIT TË NJU-JORKUT, PËRVEÇSE KUR JENI BANORË TË QYTETIT TË NJU-JORKUT** (Nëse jeni banorë të qytetit të Nju-Jorkut, nuk do t’ju jepet leja derisa të përfshini në aplikimin për leje, një kopje të lejes së drejtimit ose kartës së identifikimit për personat që nuk kanë leje drejtimi).

BANORËT E QYTETIT TË NJU-JORKUT - Departamenti i Transportit i Qytetit të Nju-Jorkut (NYC DOT) lëshon leje për banorët e qytetit të Nju-Jorkut. Nëse jeni banorë të qytetit të Nju-Jorkut dhe keni nevojë për leje parkimi, duhet ta dërgoni aplikimin tuaj dhe një kopje të lejes së drejtimit ose kartës së identifikimit për personat që nuk kanë leje drejtimi pranë Departamentit të Transportit të Qytetit të Nju-Jorkut, Shërbimi i Klientit dhe Lejet e Parkimit, në adresën 30-30 Thomson Avenue, 2nd Floor, Long Island City, NY 11101-3045. Telefononi në numrin (718) 433-3100 për informacione të mëtejshme. **Nëse nuk vini në dispozicion një kopje të lejes së drejtimit ose kartës së identifikimit për personat që nuk kanë leje drejtimi bashkë me aplikimin tuaj, Departamenti i Transportit i Qytetit të Nju-Jorkut nuk do të lëshojë leje.** Nëse dispononi targa për personat me aftësi të kufizuara të rënda, plotësoni Pjesën 1 dhe bashkëngjitni një kopje të regjistrimit tuaj. Nëse dispononi targa të personalizuar për personat me aftësi të kufizuara të rënda, bashkëngjitni një foto të targës suaj, që përmban Simbolin Ndërkombëtar të Aksesueshmërisë. Lexoni informacionin e rëndësishëm për “PARKIMIN NË QYTETIN E NJU-JORKUT” në faqen 2.

BANORËT E KONTESË SË NASSAU - Telefononi në numrin (516) 227-7399 (Zyra e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kontenë e Nassau) për të zbuluar se ku mund të aplikoni për leje parkimi.

TË GJITHË BANORËT E TJERË TË SHTETIT TË NJU-JORKUT - Telefononi bashkinë e qytetit, qytezës apo të fshatit tuaj për të zbuluar vendndodhjen e agjentit më të afërt për lëshimin e lejeve. **Pjesa më e madhe e nëpunësve të lartë të bashkisë së qytetit, qytezës apo fshatit, si dhe disa departamente policore, lëshojnë leje.** Shumica e agjentëve e pranojnë formularin MV-664.1, por disa të tjerë kanë formularin e tyre të aplikimit dhe jo të gjithë agjentët lëshojnë leje për aftësitë e kufizuara të përkohshme.

2) Për të aplikuar për targa:

- (a) Aftësia juaj e kufizuar duhet të jetë e përhershme.
- (b) Automjeti për të cilin do të përdoren targat e veçanta duhet të jetë i regjistruar në emër të personit me aftësi të kufizuara. Ju duhet të jeni të paktën 16 vjeç, në mënyrë që të keni një automjet të regjistruar në emrin tuaj.
- (c) Plotësoni Pjesën 1 të aplikimit në faqen 3. Mjeku, mjeku osteopat, ndihmës mjeku, infermieri i specializuar e Vërtetimit Mjekësor, mjeku podiatër (në rastet e aftësive të kufizuara të lidhura me këmbët) ose mjeku optometrist (në rastet e verbërisë) duhet të plotësojë seksionin për “aftësinë e kufizuar të përhershme” në Pjesën 2 të formularit të aplikimit dhe t’ju kthejë atë. SHËNIM: Kërkesa për vërtetimin mjekësor mund të hiqet nga zyra e Mjeteve Motorike nëse keni një aftësi të kufizuar të përhershme, si dhe të dukshme dhe të dallueshme (si p.sh. nuk e keni një këmbë) **OSE** nëse keni një leje parkimi të përhershme (në ngjyrë blu) për personat me aftësi të kufizuara. Mbajtësit e lejes duhet ta marrin atë me vete dhe duhet të plotësojnë Pjesën 1 të aplikimit, si dhe të bashkëngjitin një kopje të aplikimit për leje parkimi, ku përfshihet vërtetimi mjekësor ose raporti mjekësor.
- (d) Ju mund t’i merrni targat në çdo zyrë të Mjeteve Motorike. Merrni me vete aplikimin e plotësuar.
- Për të regjistruar automjetin tuaj për herë të parë, duhet të vini në dispozicion të gjitha dokumentet e nevojshme për regjistrimin fillestar dhe të përfshini vërtetimin e aftësisë së kufizuar.
 - Nëse keni targa në makinën tuaj, merrni ato me vete për t’i këmbyer me targat për personat me aftësi të kufizuara të rënda. Ju duhet të plotësoni një aplikim regjistrimi (formulari MV-82) dhe të paguani një tarifë prej 25 dollarësh për targat e reja që mbartin Simbolin Ndërkombëtar të Aksesueshmërisë (ISA).
 - Nëse ky transaksion kryhet në një periudhë tjetër nga ajo e rinovimit të regjistrimit të automjetit, ju duhet të paguani një tarifë shtesë transaksioni prej 3,75 dollarësh.
 - Targat e personalizuar me simbolin ISA janë të disponueshme në zyrën e DMV-së për Targat e Personalizuara. Për informacion, telefononi në numrin (518) 402-4838.

PËRDORIMI I TARGAVE DHE I LEJEVE TË PARKIMIT

- ◆ Targat dhe lejet e parkimit mund të përdoren për të parkuar në vende të rezervuara parkimi **vetëm kur personi që ka aftësinë e kufizuar është pasagjer ose drejton automjetin**. Personat që nuk kanë aftësi të kufizuara nuk mund të përdorin lejen tuaj të parkimit apo targat e veçanta për të parkuar në një parkim të rezervuar; personat që parkojnë në mënyrë të paligjshme në këto hapësira shkelin seksionin 1203-c(4) të ligjit “Për automjetet dhe qarkullimin rrugor” të shtetit të Nju-Jorkut dhe mund të gjobiten nga 50 deri në 75 dollarë për shkeljet për herë të parë, dhe nga 75 dollarë deri në 150 dollarë për shkeljet për herë të dytë, të cilat janë kryer brenda dy vitesh. Bashkitë mund të vendosin gjoba më të larta. Çdo person që keqpërdor apo abuzon me lejet e parkimit apo targat për personat me aftësi të kufizuara është objekt i heqjes së lejes apo targave.
- ◆ Lejet e parkimit duhet të varen në pasqyrën e brendshme të automjetit kur ai është i parkuar, por duhet të hiqen nga pasqyra gjatë drejtimit të automjetit.
- ◆ Zakonisht, targat dhe lejet janë të vlefshme kudo ku gjenden hapësira parkimi në shtetin e Nju-Jorkut, të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara. Megjithatë, përdorimi i targave apo lejeve nuk ju përjashton nga rregulloret apo tarifat shtetërore ose lokale të parkimit dhe as nga kërkesa për marrjen e lejes për të parkuar në një zonë të caktuar. Targat dhe lejet janë gjithashtu të vlefshme në shumicën e shteteve, territoreve dhe vendeve të huaja të tjera. Nëse udhëtoni jashtë Nju-Jorkut, konsultohuni me policinë apo agjencinë e Mjeteve Motorike në vendin ku do të shkoni, për t’u siguruar nëse pranohet leja apo targat tuaja.
- ◆ Hapësirat e parkimit, të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara, duhet të shënohen me shenja të përhershme dhe të jenë lehtësisht të dukshme mbi sipërfaqen e tokës, të cilat kanë simbolin e karriges me rrota. Këto shenja pozicionohen në lartësinë prej rreth pesë deri në shtatë këmbë (1,5 m deri në 2 m) mbi sipërfaqen e hapësirës së parkimit. Ndarja e hapësirave të rezervuara mund të përfshijë përdorimin e vijave apo shenjave me bojë blu. **Mos parkoni në rrugëkalimin e vijëzuar të aksesit pranë hapësirave të parkimit të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara** edhe nëse keni lejen apo targat përkatëse. Rrugëkalimet e aksesit mundësojnë hapësirë për personat në karrige me rrota dhe për automjetet me pajisje të veçanta për transferim të sigurt nga dhe në automjet.
- ◆ Bashkitë i caktojnë hapësirat e parkimit për personat me aftësi të kufizuara sipas ligjit ose urdhrave vendorë. Nëse keni pyetje lidhur me parkimin në një rrugë të caktuar për personat me aftësi të kufizuara, kontaktoni autoritetin përgjegjës për mirëmbajtjen e asaj rruge. Nëse keni pyetje rreth parkimeve të rezervuara pranë çdo godine me parking privat, kontaktoni me administratorin e godinës ose me inspektorin e ndërtesave vendore.

◆ PARKIMI NË QYTETIN E NJU-JORKUT

Qyteti i Nju-Jorkut (NYC) nuk rezervon hapësira parkimi në rrugët e tij ekskluzivisht për personat me aftësi të kufizuara. Megjithatë, bashkia lëshon një leje bashkiake për parkim të rezervuar (leje parkimi në formë drejtkëndore, e vendosur në panelin e përparmë të automjetit) që i lejon një personi me aftësi të kufizuar të rëndë të parkojë në hapësirat buzë trotuarit, të cilat nuk janë të disponueshme për shumicën e automjeteve, ose të parkojë falas në hapësira parkimi me pagesë. Kjo leje nuk është e vlefshme jashtë qytetit të Nju-Jorkut. Ju mund të merrni një leje bashkiake për parkim dhe një leje nga shteti i Nju-Jorkut, të cilat lëshohen nga Departamenti i Transportit i Qytetit të Nju-Jorkut.

Në të gjithë shtetin e Nju-Jorkut dhe në qytetin e Nju-Jorkut, hapësirat e rezervuara të parkimit janë të disponueshme në parkingjet e qendrave tregtare, ndërtesave të zyrave, pallateve dhe kapuseve të kolegjeve. Ju mund t’i përdorni targat e veçanta ose lejen shtetërore për të parkuar në hapësira të caktuara në parkingjet private.

Për më shumë informacione ose për të marrë një aplikim për leje, ju mund të vizitoni adresën e internetit të Departamentit të Transportit të Qytetit të Nju-Jorkut në www.nyc.gov/dot ose të telefononi në numrin (718) 433-3100. Ju mund të kontaktoni me Departamentin e Transportit të Qytetit të Nju-Jorkut në adresën:

NYC Department of Transportation
Permits and Customer Service
30-30 Thomson Avenue, 2nd Floor
Long Island City, NY 11101-3045

◆ PËRJASHTIMI NGA PAGESA E PARKIMIT

Nëse keni një aftësi të kufizuar në lëvizshmëri dhe një aftësi të kufizuar të rëndë që redukton aftësinë tuaj për të aksesuar apo bërë pagesën në një parkimetër, ju mund të kualifikoheni për përjashtim nga pagesa e parkimit. Përjashtimi nga pagesa e parkimit lejon personin e kualifikuar që të parkojë falas në një hapësirë parkimi me pagesë në çdo qytet, qytezë ose fshat të shtetit të Nju-Jorkut (me përjashtim të qytetit të Nju-Jorkut). Për informacione të mëtejshme, shihni formularët MV-664.1MP (Aplikimi për përjashtim nga pagesa e parkimit për personat me aftësi të kufizuara të rënda) dhe MV-664.2MP (Informacion për përjashtimin nga pagesa e parkimit). Këta formularë janë të disponueshëm përmes agjentit lëshues lokal, si dhe gjenden edhe në faqen e internetit të DMV-së në adresën dmv.ny.gov.

Lexoni faqet 1 dhe 2 të këtij materiali, përpara se të plotësoni këtë aplikim. Nëse aplikoni për leje parkimi, dorëzoheni aplikimin e plotësuar te agjenti lëshues (bashkia) në qytetin, qytezën ose fshatin ku jetoni; **mos e dërgoni aplikimin tuaj te Departamenti i Mjeteve Motorike, pasi DMV-ja nuk lëshon leje parkimi.**

Pjesa 1 INFORMACIONE RRETH PERSONIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA — (Shkruani me germa të mëdha dhe nënshkruani krahas shigjetës.)

Mbiemri	Emri	Iniciali i emrit të dytë	Nr. i telefonit
---------	------	--------------------------	-----------------

Adresa: Nr. dhe Rruga	Nr. i ap.	Qyteti	Shteti	Kodi postar
-----------------------	-----------	--------	--------	-------------

Datëlindja	Gjinia <input type="checkbox"/> M <input type="checkbox"/> F <input type="checkbox"/> X	Dëshiroj <input type="checkbox"/> Targa (Aplikoni pranë DMV-së) <input type="checkbox"/> Leje parkimi (Aplikoni pranë agjentit lëshues lokal)
------------	---	---

A keni targa për personat me aftësi të kufizuara?
 Po - Numri i targës sime është: _____ Jo

Banorët e qytetit të Nju-Jorkut - Bashkëngjitni një kopje të lejes së drejtimit ose të kartës së identifikimit për personat që nuk kanë leje drejtimi. Nëse keni pasur një leje parkimi nga shteti i Nju-Jorkut, shkruani numrin e lejes këtu:

Lexoni shënimin në faqen 4 përpara se të nënshkruani

X _____
 (Nënshkrimi i personit me aftësi të kufizuara ose nënshkrimi i prindit apo kujdestarit) — Nëse nënshkruhet _____ (Data)
 nga një prind apo kujdestar, shkruani marrëdhënien tuaj me personin me aftësi të kufizuara, pas nënshkrimit.

Pjesa 2 VËRTETIMI MJEKËSOR

SHËNIM: Vërtetimi i **AFTËSIVE TË KUFIZUARA** mund të kryhet nga një mjek (MD), mjek osteopat (DO), ndihmës mjek (PA), infermier i specializuar (NP), një mjek podiatër (DPM, për aftësitë e kufizuara të këmbëve) ose nga një optometrist (OD, për rastet e verbërisë). Sidoqoftë, **AFTËSITE E KUFIZUARA TË PËRKOHSHME**, mund të vërtetohen vetëm nga një mjek ose mjek osteopat.

Shënoni kutinë(kutitë) që përshkruajnë aftësinë e kufizuar dhe plotësoni diagnozën:

AFTËSIA E KUFIZUAR E PËRKOHSHME: Një person me aftësi të kufizuara të përkohshme është çdo person që përkohësisht nuk mund të ecë pa ndihmën e një pajisjeje ndihmëse. Disa shembuj të një pajisjeje ndihmëse përfshijnë, ndër të tjera, pajisjet ortopedike, bastunët, patericat, protezat, një person tjetër ndihmës, karriget me rrota ose ndihmëset për ecje. **E RËNDËSISHME:** Lejet e përkohshme lëshohen për gjashtë muaj ose më pak, pavarësisht nga data e parashikuar e rikuperimit.

Data e parashikuar e rikuperimit: _____ **Diagnoza:** _____

Çfarë pajisjeje ndihmëse nevojitet? _____

AFTËSIA E KUFIZUAR E PËRHERSHME: Një person me “aftësi të kufizuar të rëndë” është çdo person që ka një ose disa nga dëmtimet, aftësitë e kufizuara ose problemet e PËRHERSHME të renditura më poshtë, të cilat kufizojnë lëvizshmërinë.

Diagnoza: _____ Shënoni **problemet përkatëse:**

Përdor pajisje portative oksigjeni Aftësi shumë të reduktuara shikimi Funksionim i kufizuar ose mosfunksionim i njërës ose të dyja këmbëve Paaftësi për të ecur deri në 200 këmbë (60 metra) pa ndalim

Çrregullim neuromuskular që kufizon ndjeshëm lëvizshmërinë Probleme kardiake të kategorisë III ose IV.
 (Sipas standardeve të Shoqatës Amerikane për Problemet Kardiake)

Aftësi shumë e kufizuar në të ecur për shkak të një problemi reumatik, neurologjik ose ortopedik

Kufizohet nga një sëmundje pulmonare, deri në masën që vëllimi i ekspirator (respirator) i sforcuar për një sekondë, kur matet me spirometër, është më pak se një litër, ose kur tensioni i oksigjenit arterial është më pak se 60 mm/hg në ajër ambient, në gjendje pushimi

Ka një çrregullim fizik ose mendor, ose një problem që nuk është renditur më sipër, i cili konsiston në një shkallë të barabartë aftësie të kufizuar dhe që shkakton vështirësi të mëdha në përdorimin e transportit publik dhe nuk i jep mundësinë personit që të lëvizë me lehtësi.

SHPJEGONI MË POSHTË SE SI AFTËSIA E KUFIZUAR REDUKTON LËVIZSHMËRINË FUNKSIONALE.

Emri i MD/DO/DPM/NP/PA/OD	Nr. i licencës profesionale
Adresa e MD/DO/DPM/NP/PA/OD	Nr. i telefonit

Lexoni shënimin në faqen 4 përpara se të nënshkruani

X _____
 (Nënshkrimi i MD/DO/DPM/NP/PA/OD) _____ (Data)

Part 3 FILE INFORMATION (For Issuing Agent Use Only)

Blue Red **Parking Permit No.** _____ Date Issued: _____ Date Expires: _____

First Second 9-digit number from NYS Driver License/ID Card _____

Denied Revoked Reason: _____ (Date)

X _____
 (Issuing Agent) _____ (Locality)

SHËNIM PËR KLIENTËT DHE PROFESIONISTËT E SHËNDETËSISË

Sipas ligjit “Për automjetet dhe qarkullimin rrugor” dhe Ligjit Penal të shtetit të Nju-Jorkut, bërja e një deklaratë të rreme ose dhënia e informacionit të rremë në një aplikim për leje parkimi apo targa për një person me aftësi të kufizuara të rënda përbën krim (vepër penale ose shkelje). Ky krim dënohet me gjobë, burgim ose të dyja. Nëse ky krim përfshin një aplikim për leje parkimi, krimi mund të rezultojë edhe në përgjegjësinë për të paguar një sanksion civil prej 250 - 1000 dollarësh.

Për klientët që dëshirojnë targa ose leje parkimi për personat me aftësi të kufizuara:

Kur nënshkruani, Pjesën 1 të këtij aplikimi, ju vërtetoni se:

- informacionet e dhëna në këtë aplikim janë të vërteta;
- keni lexuar dhe kuptuar kushtet për “Përdorimin e targave dhe lejeve të parkimit”, të paraqitura në faqen 2; dhe
- ju bini dakord t'i respektoni këto kushte.

Për profesionistët e shëndetësisë që japin informacione mjekësore në mbështetje të një aplikimi për targa ose leje parkimi për personat me aftësi të kufizuara:

Kur nënshkruani, Pjesën 2 të këtij aplikimi, ju vërtetoni se:

- informacioni mjekësor që keni dhënë është i vërtetë dhe i plotë; dhe
- sipas gjykimit tuaj, personi i specifikuar në Pjesën 1 të aplikimit është i kualifikuar nga pikëpamja mjekësore, për të marrë targat ose një leje parkimi si person me aftësi të kufizuara, sipas kriterëve mjekësore të cilësuar në Pjesën 2.

